

SPECIFIKIMET TEKNIKE

26.1 Grumbullimi dhe Transportimi i Mbetjeve Urbane dhe Tregjeve.

26.1.1 Volumet e punimeve

Autoriteti kontratues ka parashikuar paraprakisht të gjitha pikat e grumbullimit të mbetjeve për vendosjen e **1532** kontenierëve të ndara në **573 PGM (pika të grumbullimit të mbetjeve)** me volum 1.7 m³, brenda zonës së kontraktuar, nga të cilët **210** kontenierë do të do shërbejnë për procesin e grumbullimit të ndarë të mbetjeve në zonën “Tirana 4”.

Operatori i shërbimit duhet të kryejë shërbimin e plotë të parashikuar në metodologji, **1532** zbrazje kontenierësh/ditë.

Këto janë paraqitur në listën e pikave të vendosjes së kontenierëve për grumbullimin e mbetjeve në zonën **Tirana 4** dhe sipas hartës së zonës.

26.1.2 Specifikime teknike dhe metodologjia

Shërbimi i grumbullimit, largimit dhe transportit të mbetjeve të ngurta urbane konsiston në:

a. Zbrazjen e kontenierëve me makinën e përshtatshme teknologjike të përcaktuar, mbledhjen dhe largimin e mbeturinave të hedhura përreth në një distancë me rreze prej 10 m nga çdo kontenier, pastrimin dhe fshirjen me fshesë me dorë të sipërfaqes prej 30 m² rreth çdo pike grumbullimi, si dhe rivendosja e kontenierëve të sistemuar në vendin e caktuar. Kontenierët duhet të vendosen drejt, në pozicion vertikal dhe në mënyrë estetike për mjedisin urban dhe me kapakë të mbyllur. Më pas makinat teknologjike kryejnë transportin e mbeturinave në fushën e depozitimit të tyre.

b. Duhet të bëhet dezinfektimi ditor, pas zbrazjes së çdo kontenieri, me pluhur gëlqereje me 5% përmbajtje klori, brenda çdo kontenieri ose duke përdorur sistemin e dezinfektimit që duhet ta ketë çdo makinë teknologjike, duke përdorur të tretur lëndën e pluhurit të gëlqeres me 5% përmbajtje klori.

26.1.3 Plani i vendosjes së kontenierëve dhe grafikët e punimeve

a. Autoriteti kontrator ka përcaktuar pikat ekzakte të grumbullimit të mbetjeve të ngurta urbane, dhe numrit të kontenierëve për secilën pikë, në të gjithë zonën ku përfshihen edhe të gjitha pikat e grumbullimit pranë të gjitha tregjeve brenda zonës (573 PGM pjesa Tirana 4. (Vendosja e tyre në vendet e përcaktuara do të bëhet sipas sistemit kordinativ(x,y) WGS 1984).

b. Operatori i shërbimit është i detyruar të zbatojë planin fillestar të pikave dhe kontenierëve të kërkuar (bashkëngjitur specifikimeve teknike) si dhe çdo ndryshim të tyre përgjatë kohës së zbatimit të kësaj kontrate. Ky plan mund të ndryshojë gjatë kohës së zbatimit të kontrates me propozim të operatorit të shërbimit ose nga Autoriteti kontrator sipas nevojave për përmiresimin e shërbimit dhe mirë organizimit të tij, ose si rezultat i

ndryshimeve që mund të ndodhin në infrastrukturë gjithmonë pas kërkesës së njëres palë dhe bëhen të zbatueshme pas miratimit të Autoritetit kontraktor.

c. Grafikët vjetor të punimeve për realizimin e shërbimit të pastrimit të zonës, përgatiten nga operatori i shërbimit dhe miratohen çdo vit nga Autoritetit kontraktor. Këta grafikë mund të pësojnë ndryshime sa herë konsiderohet e nevojshme edhe brenda një viti. Në grafikun e punimeve duhet të përcaktohen saktë:

1. Oraret e operimit në secilën pikë kontenierësh.
2. Llojin, targën dhe intenerarin e makinave teknologjike që do të kryejnë shërbimin.
3. Oraret e operimit dhe mjetet për shërbimet mbështetëse.
4. Numrin e punëtorëve që do të mbështesin çdo operacion punimesh.

Grafikët e punimeve duhet të zbatohen rigorozisht nga operatori i shërbimit. Operatori i shërbimit nuk mund të paguhet pa miratimin paraprak të grafikut të punimeve apo kur grafikut i ka kaluar afati i zbatimit.

d. Grafikët për largimin e mbeturinave që do të paraqiten për miratim, duhet të përgatiten në mënyrë të tillë që të gjitha punimet të kryhen brenda orëve të natës (për zonën urbane dhe gjysëm urbane) duke filluar jo më parë se ora 19.00, me qëllim që në orën 7.00 zona urbane dhe gjysëm urbane të jetë krejtësisht e pastër, ndërsa për zonën rurale ky shërbim të kryhet gjatë ditës.

Ndryshimet në orarin e operimit dhe përfundimit të shërbimit në zonë, do të pranohen vetëm për shkak të pamundësisë objektive të kryerjes së shërbimit të parashikuar si dhe në rastet e ndryshimit të orarit për rrugët tregtare, por gjithmonë pasi të jenë verifikuar dhe miratuar zyrtarisht nga Autoriteti kontraktor, ndryshimet në Grafikun e Punimeve.

e. Autoritetit kontraktor ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim vendet e grumbullimit të mbeturinave për të parë kryerjen e shërbimeve të sipër përmendura, respektimin e standarteve të kërkuara, rregullave dhe cilësisë së kërkuar nga kjo kontratë dhe për të vendosur ndalesa, penalitete dhe gjopa për mospërmbushjen e tyre.

f. Në rast se për arsye objektive nuk arrihet vendosja e planifikuar e numrit të konteinerëve dhe e pikave të grumbullimeve të mbetjeve, shërbimi i grumbullimit dhe transportit të mbetjeve do të shpeshtohet në funksion të sasisë së depozituar të mbetjeve por gjithmonë duke mos kaluar parashikimin kontraktual dhe preventivin e punimeve.

26.1.4 Rregulla për tu zbatuar

a. Për asnjë rast nuk do të lejohen kazanë të tejmbushur me mbeturina, të pa transportuara dhe mbeturina të lëna në zonën përreth kontenierëve. Në të gjitha rastet kur evidentohen bllokime apo pengesa nga faktorë të jashtëm, operatori i shërbimit duhet të njoftojë menjëherë dhe të marrë masa për pastrimin e tyre jo më vonë se 1 orë nga orari i përfundimit të shërbimit, i përcaktuar në grafik. Në rast të kundërt përgjegjësia është e operatorit të shërbimit dhe do të vendosen penalitete.

b. Operatori i shërbimit ka për detyrë të kryejë grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve urbane që depozitohen në ambjente publike brenda zonës së kontraktuar edhe në rast se hidhen larg pikave të miratuara të grumbullimit të tyre. Në rastet kur mbetjet hidhen në mënyrë të përsëritur operatori i shërbimit ka të drejtë të kërkojë miratimin e vendosjes së kontenierëve dhe përfshirjen në grafikun e punimeve.

c. Operatori i shërbimit duhet të informojë me shkrim Autoritetin kontraktor në mënyrë periodike për të gjitha kontratat private të pastrimit që do ketë me të tretë, të reklamojë numrin e mjeteve dhe punëtorë shtesë për këto shërbime për të garantuar cilësinë e kërkuar të shërbimeve në kontratën me Autoritetin kontraktor.

d. Operatori i shërbimit duhet të ketë në efikasitet një “Zyrë të Kontaktimit” për marrjen e ankesave e cila duhet të jetë e hapur në të gjithë ditët e javës nga ora 7.00-20.00 . Përfaqësues të operatorit të shërbimit duhet të jenë prezent gjatë gjithë kohës së parashikuar për të marrë vërejtjet e qytetarëve dhe Autoritetit kontraktor dhe për t’u dhënë zgjidhje problemeve të prezantuara brenda 2 orësh nga marrja e njoftimit.

e. Operatori i shërbimit detyrimisht duhet të ketë çdo ditë (ose natë) në punë, minimalisht numrin e kërkuar të makinerive, pajisjeve.

f. Operatori i shërbimit detyrimisht duhet të ketë çdo ditë në punë minimalisht numrin e punëtorëve të transportit dhe shoferëve sipas numrit të deklaruar në ofertën e tenderit për të garantuar kryerjen me cilësi dhe në kohë të shërbimit.

g. Në asnjë rast nuk duhet të kryhet largimi i mbeturinave urbane nga kontenerët në akset kryesore, para se të jetë kryer fshirja dhe pastrimi i rrugëve ku ndodhen. Në të kundërt operatori i shërbimit duhet kryejë përsëri zbrazen e kontenerëve pa shpenzime ose duhet të përdorë mjete shtesë për të garantuar që kontenerët të jenë bosh pas përfundimit të të gjitha shërbimeve të pastrimit.

h. N.q.s gjatë transportit derdhen papastërti nga makinat e shërbimit, brenda ose jashtë zonës së shërbimit, ato duhet të pastrohen menjëherë. Në të kundërt përveç shpenzimeve që duhet të përballojë kontraktori për mbledhjen dhe largimin e mbeturinave të rena gjatë transportit, ai do të përballë me penalitetet e parashikuara në përputhje me këtë kontratë apo me gjopa të tjera në përputhje me ligjet dhe vendimet në fuqi për ndotjen e shkaktuar.

i. Përdorimi i uniformave për punëtorët që kryejnë shërbimin e pastrimit është rigorozisht i detyrueshëm dhe në rast mozbatimi aplikohen gjopa për mosplotësim këtij detyrimi.

26.1.5 Mjetet dhe pajisjet

Operatori i shërbimit duhet të vërë në dispozicion për plotësimin e detyrimeve kontraktuale, (mbledhjes, transportit, largimit të mbeturinave) dhe të gjitha Shërbimeve Plotësuese të përcaktuara më lart, këto mjete dhe pajisje:

Makina e nevojshme teknologjike për grumbullimin dhe transportin e mbeturinave urbane si dhe shërbimeve mbështetëse, të kërkuara për realizimin e kontratës, janë të renditura si më poshtë:

1. Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës 10-12 ton, raport kompaktimi 1:4 - 1:6, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2010, jo më pak se **13 (trembëdhjetë) copë;**

2. Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës jo më pak se 5-7 ton, raport kompaktimi 1:4 - 1:6, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2010, jo më pak **2 (dy) copë**;
3. Të gjitha makineritë teknologjike që do përdoren për zbatimin e kësaj kontrate duhet të jenë në përputhje me të dhënat teknike dhe specifike të mjeteve të përcaktuara në kapitullin “Specifikimet teknike”, pjesë përbërëse e dokumentave të tenderit.

4. Rregulla të tjera për mjetet dhe pajisjet:

- a. Të gjitha mjetet të cilat do të përdoren nga operatori i shërbimit për plotësimin e detyrimeve kontraktuale, mund të kontrollohen në çdo kohë nga Autoriteti kontraktor për gjëndjen e gadishmërisë dhe inventarizimin e tyre.
- b. Të gjitha mjetet të cilat do të përdoren, duhet të jenë të identifikuar nga Autoriteti kontraktor. Ato duhet të mbahen në gjëndje të pastër dhe të rregullt si dhe të jenë të lyera me të njëjtën ngjyrë. Një pjesë e konsiderueshme e pjesëve të ndërrimit duhet të jenë gjendje për të siguruar plotësimin e gatishmërisë së mjeteve.
- c. Mjetet e largimit të mbeturinave duhet të lahen dhe dezinfektohen çdo ditë pas përfundimit të punës.
- d. Të gjithë kontenierët e përdorur për zbatimin e kontratës duhet të mbahen të pastër, në gjëndje të mirë teknike. Në rast dëmtimesh, djegiesh, deformimesh të kontenierëve, si dhe dëmtime rrotash dhe kapakësh, të cilat çojnë në mosfunksionimin e plote teknik, higjienik ose estetik të tij gjatë kohëzgjatjes së kontratës si dhe mungesës së kontenierëve, operatori i shërbimit ka përgjegjësinë për ruajtjen, mirëmbajtjen dhe riparimin e kontenierëve për çdo rast dhe për çdo shkak. Operatori do të riparojë ose të zëvendësojë kontenierët brenda 15 ditëve nga momenti i konstatimit të dëmtimit dhe/ose njoftimit nga Autoriteti kontraktor për dëmtimin e kontenierëve. Në rast të mosriparimit të plotë të kontenierëve ndaj operatorit të shërbimit aplikohen penalitete.
- e. Operatori i shërbimit duhet të vërë në përdorim emrin e tij për korespondencën e përbashkët, lidhjen telefonike, shenjat dhe targat e makinave dhe kontenierëve.
- f. Detyrimisht në të gjithë makinat dhe kontenierët duhet të shkruhen mesazhe për edukimin mjedisor, numri i telefoni i gjelbër i Autoritetit kontraktor sipas një formati të miratuar paraprakisht po nga Autoriteti Kontraktor. Gjithashtu në të gjitha mjetet dhe kontenierët e shpërndarë përveç mbishkrimeve të mësipërme, duhet të prezantohen shpjegues të qartë për llojin e mbeturinave që mbliidhen, si dhe orarin kur largohen mbeturinat.

26.2 Larja dhe dezinfektimi i kontenierëve

26.2.1 Volumet e punimeve

Operatori i shërbimit do të lajë dhe dezifektojë 1532 kontenierë të volumeve 1.7 m³/ në muaj ose mesatarisht 51 kontenierë/ditë, sipas grafikëve të miratuar nga Autoriteti kontraktor.

26.2.2 Metodologjia

1. Operatori i shërbimit do të grumbullojë dhe transportojë kontenierët çdo natë në autoparkun e tij dhe të kryejë larjen e plotë dhe dezifektimin e tyre atje. Kontenierët do të largohen detyrimisht pas zbrazjes së plotë të tyre.
2. Për të mundur kryerjen e këtij shërbimi operatori i shërbimit do të ketë në dispozicion një numër të nevojshëm kontenierësh rezervë për të zëvendësuar çdo natë kontenierët e larguar për tu larë.
3. Kontenierët për mbledhjen e mbeturinave urbane detyrimisht lahen nga brenda dhe nga jashtë me ujë me presion, duke përdorur furçe dhe solucione larëse.
4. Me shërbim dezifektimi kuptojmë realizimin shërbimit të dezifektimit dhe deratizimit të të gjithë sipërfaqes së jashtme dhe të brendshme të kontenierit.

26.2.3 Grafikët e punimeve

1. Grafikët e punimeve për transportin, larjen dhe dezifektimin e kontenierëve, përgatiten nga Operatori i Shërbimit dhe miratohen çdo vit nga Autoriteti kontraktor.
2. Grafikët e punimeve duhet të zbatohen rigorozisht nga operatori i shërbimit.
3. Autoriteti kontraktor ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim vendet e grumbullimit të mbeturinave për të parë kryerjen e shërbimeve të sipër përmendura, respektimin e standarteve të kërkuara, rregullave dhe cilësisë së kërkuar dhe për të vendosur penalitete, gjoba dhe ndalesa për mospërmbushjen e tyre.

26.2.4 Rregulla për t'u zbatuar

1. Ky shërbim do të kryhet detyrimisht pasi të jetë bërë zbrazja dhe pastrimi i kontenierëve të mbledhjes së mbeturinave urbane, tregjeve, etj..

26.2.5 Mjetet dhe pajisjet

1. Makine transportuese të kontenierëve me platformë ngarkimi nga pas, për të mundur ngarkimin dhe shkarkimin e kontenierëve pa sjellë dëmtimin e tyre, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2010, jo më pak se **1 (një)copë**.
2. Lëndë dezifektuese dhe aromatizuese për dezifektimin e kontenierëve.
3. Operatori i shërbimit duhet të ketë të instaluar në autoparkun e tij depozitë uji dhe një tjetër për lëndën dezifektuese si dhe mjete pune (pompë dhe pistoleta uji) për larjen me presion dhe dezifektimin e kontenierëve.
4. Një sasi e konsiderueshme e pjesëve të ndërrimit duhet të mbahen gati për të siguruar plotësimin në kohë dhe të vazhdueshëm të kontratës.

26.3 Mirëmbajtja e vendgrumbullimeve të mbetjeve gjatë ditës dhe grumbullimi i mbetjeve ndërtimore dhe të vëllimshme.

26.3.1 Volumet e punimeve

Autoriteti kontraktor ka parashikuar paraprakisht pikat e grumbullimit të mbetjeve, **573** vendgrumbullime mbetjesh. Shërbimi i mirëmbajtjes gjatë ditës dhe grumbullimi i mbetjeve ndërtimore dhe të vëllimshme, do të kryhet në të gjitha pikat e grumbullimit si dhe në gjithë hapësirat publike e territoriale të zonës së kontratuar.

Këto janë paraqitur në listën e pikave të vendosjes së kontenierëve për grumbullimin e mbetjeve në zonën “Tirana 4” si dhe në hartën për këto zone.

26.3.2 Metodologjia e punës dhe rregulla për zbatim.

Shërbimi i mirëmbajtjes së pikave gjatë ditës dhe grumbullimi i mbetjeve ndërtimore dhe të vëllimshme, konsiston në:

a. Mirëmbajtjen dhe pastrimin gjatë ditës të mbetjeve urbane të hedhura dhe depozituara jashtë kontenierëve, mbetjeve ndërtimore dhe të vëllimshme të depozituara në zonën perkatese, si dhe të mbetjeve urbane voluminoze (amballazhe) që tejmbushin artificialisht kontenierët dhe pengojnë mbetjet e tjera urbane për t’u depozituar nëpër kontenierë, në mënyrë që të gjitha pikat dhe kontenierët të jenë të pastër në vazhdimësi gjatë gjithë ditës. Nuk ka kufizime në pastrimin e sipërfaqes rreth kontenierit dhe operatori i shërbimit është i detyruar të largojë çdo mbetje urbane në të gjithë zonën perkatese sado larg kontenierit të jetë hedhur.

b. Për grumbullimin dhe ngarkimin e mbeturinave inerte dhe të vëllimshme, të hedhura jashtë kontenierëve, si dhe në gjithë hapësirat publike dhe territoriale të zonës do të përdoren kamionçina vetshkarkuese me mbulesa të posaçme për mos lejuar derdhjen e mbetjeve. Sipas nevojave që mund të ketë çdo pikë mund të jetë e nevojshme pastrimi disa herë në ditë të pikave dhe kontenierëve mbi të cilët në vazhdimësi ndotet gjatë orëve të ndryshme të ditës.

d. Pas pastrimit kontenierët kthehen në vendqëndrimin e tyre të mëparshëm.

f. Grafikët vjetor të punimeve për realizimin e këtij shërbimi, përgatiten nga sipermarrësi dhe miratohen çdo vit nga Autoriteti kontraktor. Këta grafikë mund të pësojnë ndryshime sa herë lind e nevojshme edhe brenda një viti. Në grafikun e punimeve duhet të përcaktohen saktë:

1. Oraret e operimit në secilën vendgrumbullim mbetjesh.
2. Llojin, targën dhe intenerarin e makinave teknologjike që do të kryejnë shërbimin.
3. Oraret e operimit dhe mjetet për shërbimet mbështetëse.
4. Numrin e punëtorëve që do të mbështesin çdo operacion punimesh.

g. Grafikët e punimeve duhet të zbatohen rigorozisht nga operatori i shërbimit.

h. Grafikët që do të paraqiten për miratim, duhet të pregatiten në mënyrë të tillë që punimet të fillojnë nga ora 10.00 deri në 18.00 , me qëllim që gjithë kësaj periudhe kohore të gjithë kontenierët dhe vendet rreth tyre të jenë krejtësisht të pastër. Ndryshimet në orarin e operimit dhe përfundimit të shërbimit në zonë, do të pranohen vetëm për shkak të pamundësisë objektive të kryerjes së shërbimit të parashikuar si dhe në rastet e ndryshimit të orarit për rrugët tregtare, por gjithmonë pasi të jenë verifikuar dhe miratuar zyrtarisht nga Autoriteti kontraktor, ndryshimet në Grafikon e Punimeve.

i. Autoriteti kontraktor ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim vendet e grumbullimit të mbeturinave për të parë kryerjen e shërbimeve të sipër përmendura, respektimin e standarteve të kërkuara, rregullave dhe cilësisë së kërkuar dhe për të vendosur ndalesa, penalitete dhe gjoha për mospërbushjen e tyre.

j. Operatori i shërbimit duhet të mbajë të pastër pikën e grumbullimit të mbeturinave në përputhje me Rregullores me VKB Nr.1 dt.05.02.2007 “Për Administrimin e Mbetjeve Urbane dhe Pastrimit të Qytetit”.

k. Për asnjë rast nuk do të lejohen kontenierë të tejmbushur me mbetje urbane, ndërtimore, të vëllimshme dhe sipërfaqe rreth tyre të papastruara. Në të gjitha rastet kur evidentohen bllokime apo pengesa nga faktorë të jashtëm, operatori i shërbimit duhet të njoftojë menjëherë dhe të marrë masa për pastrimin e tyre jo më vonë se 1 orë nga njoftimi apo konstatimi i problemit. Në rast të kundërt përgjegjësia është e operatorit i shërbimit dhe do të përballet me penalitetet e parashikuara në përputhje me me ligjet dhe vendimet në fuqi për ndotjen e shkaktuar.

l. Operatori i shërbimit detyrimisht duhet të ketë çdo ditë (ose natë) në punë, minimalisht numrin e kërkuar dhe deklaruar të të makinerive dhe pajisjeve dhe punëtorë për kryerjen me cilësi të këtij shërbimi.

m. Nëqoftë se gjatë transportit derdhen papastërti nga makinat e shërbimit, brenda ose jashtë zonës së shërbimit, ato duhet të pastrohen menjëherë. Në të kundërt përveç shpenzimeve që duhet të përballojë operatori i shërbimit për mbledhjen dhe largimin e mbeturinave të rëna gjatë transportit, ai do të përballet me penalitetet dhe gjoha në përputhje me ligjet dhe vendimet në fuqi për ndotjen e shkaktuar.

n. Përdorimi i uniformave për punëtorët që kryejnë shërbimin e pastrimit është rigorozisht i detyrueshëm dhe në rast mosbatimi aplikohen gjoha për mosplotësim këtij detyrimi.

P. Në rast se për arsye objektive nuk arrihet vendosja e planifikuar e numrit të pikave vendgrumbullimeve të mbetjeve, shërbimi i grumbullimit dhe transportit të mbetjeve voluminoze pagesa për këtë shërbim do të kryhet sipas numrit faktik të këtyre vendgrumbullimeve në terren. Cdo ndryshim do të reflektohet në situacionet mujore të pagesave.

26.3.3 Mjetet dhe pajisjet

Operatori i shërbimit duhet të vërë në dispozicion për kryerjen e këtij shërbimi, këto mjete dhe pajisje:

Makina e nevojshme teknologjike për grumbullimin dhe transportin e mbeturinave urbane dhe mbetjeve ndërtimore, të vëllimshme si dhe shërbimeve mbështetëse, të kërkuara për realizimin e kontratës, janë të renditura si më poshtë:

2. Makinë vetëshkarkuese e hapura nga sipër, me hapje të spondit anësor ose nga pas, të pajisura me mbulesë, për grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve vëllimshme dhe të ndërtimit dhe mirëmbajtje të pikave gjatë ditës, etj; me kapacitet transportues 3.5 ton dhe volum vaske jo me te vogel se 5 m³. Viti i prodhimit jo më poshtë se 2010. Jo më pak se **5 (pesë) copë**;
3. Vegla pune si lopata, fshesa për të gjithë shoferët dhe punëtorët.
4. Çdo makineri për kryerjen e këtij shërbimi duhet të pastrohet dhe lahet, në fillim ose në fund të itinerarit ditor.
5. Një listë e makinave për transportin e mbeturinave inerte dhe skeletike do t'i paraqitet Autoritetit kontraktor para fillimit të veprimtarisë së mësipërme
6. Një sasi e konsiderueshme e pjesëve të ndërrimit dhe një numër kontenierësh me volum të madh duhet të mbahen gati për të siguruar plotësimin në kohë dhe të vazhdueshëm të kontratës.
7. Detyrimisht në të gjithë makinat duhet të shkruhet mesazhe për edukimin ambjental, numri i telefonit i gjelbër i Autoritetit kontraktor sipas një formati të miratuar paraprakisht.

26.4 Fshirja e rrugëve dhe trotuareve me krahë.

26.4.1 Volumet e Punimeve

Autoriteti kontraktor ka parashikuar paraprakisht sheshet, rrugët, trotuaret dhe sipërfaqet e tyre për të gjithë zonën e kontraktuar.

Operatori i shërbimit do të fshijë me krahë dhe do të kryejë të gjitha shërbimet e tjera mbështetëse parashikuar në metodologji për të gjitha rrugët dhe trotuaret e përcaktuara, në zonën që do të kontraktohet, në një sipërfaqe të përgjithshme prej **813,184** m² në ditë. Këto janë parashikuar në listën e rrugëve dhe volumet e tyre për shërbimin e fshirjes për zonën Tirana 4, sipas hartës bashkëngjitur.

26.4.2 Specifikime teknike dhe metodologjia

Shërbimi i fshirjes së rrugëve dhe trotuareve me krahë konsiston në:

- a. Fshirjen me punëtorë me fshesë të gjithë rrugëve kryesore, shesheve dhe rrugëve dytësore, të kategorive I, II, duke mbuluar sipërfaqen e plotë të trotuarit dhe një sipërfaqe rruge 2 m nga kuneta, në gjithë gjatësinë lineare të saj (për rrugët e kategorisë së I), si dhe sipërfaqen e plotë rrugë + trotuar për kategorinë e III.
- b. Në vendet ku është e pamundur të kalojë fshesa anësore e makinës teknologjike, (si psh. poshtë makinave apo kur ka pengesa të tjera) Operatori i Shërbimit duhet të pastrojë me punëtorë.

c. Fshirjen dhe pastrimin me punëtorë pastrimi të gjitha segmenteve të zëna nga parkimi, trotuareve, dhe rrugëve dytësore në të cilat është e pamundur kryerja e pastrimit me mjete teknologjike.

d. Pas fshirjes me makineri teknologjike, punëtorët e pastrimit (fshirjes) pastrojnë çdo lloj mbeturine që ka mbetur nga procesi teknologjik i fshirjes, në mënyrë që rrugët të jenë plotësisht të pastra. Edhe ky shërbim manual pastrimi përfshihet në procesin e fshirjes si dhe në çmimin për njësi të saj.

e. Operatori i shërbimit duhet të zbrazë, pastrojë vendin përreth dhe të mbajë pastër çdo ditë të gjithë koshat rrugore brenda zonës së kontraktuar. Për këtë operojnë punëtorë dhe makina të veçanta. Shërbimi i zbrazjes dhe pastrimit të ambientit rreth tyre bëhet gjatë natës.

f. Procesit të fshirjes dhe pastrimit i nënshtrohen të gjitha rrugët dhe trotuaret e parashikuara në zonën e kontraktuar (të asfaltuara, me kalldrëm si dhe trotuaret e qytetit).

26.4.3 Plani i punës dhe grafikët e punimeve

a. Fshirja e rrugëve do të bëhet gjatë natës nga ora 21.00-04.00.

b. Për pastrimin e rrugëve të pandriçuara Autoriteti kontraktor mund të ndryshojë dhe miratojë grafikun dhe oraret e shërbimit, pas kërkesës të njëjës palë, për të mundësuar kryerjen me cilësi të shërbimit.

Këtu mund të përfshihen edhe rrugët brenda blloqeve të banimit apo rrugët dytësore që kanë lehtësi pastrimi gjatë ditës nga mungesa e parkimit.

c. Grafikët e punimeve për realizimin e shërbimit të pastrimit të zones, përgatiten nga operatori i shërbimit dhe miratohen çdo vit nga Autoriteti kontraktor. Këta grafikë mund të pësojnë ndryshime në orën e operimit dhe përfundimit të shërbimit, sa herë lind e nevojshme edhe brenda një viti, vetëm për shkak të pamundësisë së kryerjes apo në rastet e ndryshimit të parkimit të makinave për rrugë të veçanta dhe ditë të veçanta dhe gjithmonë pasi të jenë miratuar zyrtarisht nga Autoriteti kontraktor këto ndryshime.

d. Në grafikun e punimeve duhet të përcaktohen saktë:

1. Oraret e operimit në secilën rrugë dhe trotuar.
2. Numri i punëtorëve që do të punojnë në çdo operacion punimesh.

e. Grafikët e punimeve duhet të zbatohen rigorozisht nga operatori i shërbimit.

f. Autoriteti kontraktor ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim kryerjen e shërbimeve të sipër përmendura, respektimin e standarteve të kërkuara, rregullave dhe cilësisë së kërkuar nga kjo kontratë si dhe për të vendosur penalitete, gjopa dhe ndalesa për mospërmbushjen e tyre.

26.4.4 Rregulla për t'u zbatuar

a. Për asnjë rast nuk do të lejohen rrugë të papastruara apo mbeturina të pa larguara në to. Në të gjitha rastet kur evidentohen bllokime apo pengesa nga faktorë të jashtëm të cilat nuk

mund të pastrohen me operacionet e parashikuara në metodologji, operatori i shërbimit duhet të njoftojë menjëherë dhe të marrë masa për pastrimin e tyre jo më vonë se 2 orë nga orari i përfundimit të shërbimit, i përcaktuar në grafik. Në rast të kundërt përgjegjësia është e operatorit të shërbimit.

b. Operatori i shërbimit duhet të ketë në efikasitet një “Zyrë të Kontaktimit” për marrjen e ankesave e cila duhet të jetë e hapur në të gjithë ditët e javës nga ora 7.00-20.00 . Përfaqësues të operatorit i shërbimit duhet të jenë prezent gjatë gjithë kohës së parashikuar për të marrë vërejtjet e qytetarëve dhe Autoritetit kontraktor dhe për tu dhënë zgjidhje problemeve të prezantuara brenda 2 orësh nga marrja e njoftimit.

c. Operatori i shërbimit detyrimisht duhet të ketë çdo ditë në punë minimalisht numrin e punëtorëve dhe pajisjeve sipas numrit të deklaruar në ofertën e tenderit për të garantuar kryerjen me cilësi dhe në kohë të shërbimit.

d. Për raste të veçanta operatori i shërbimit është i detyruar të fshijë rrugët më shumë se një herë pa shpenzime.

e. Gjatë procesit të fshirjes i ndalohet kategorikisht hedhja e mbeturinave në pusetat e elektrikut, telefonisë, të ujësjellësit, ujrave të zeza, hidrantëve, në zgarat e pusetave të ujrave atmosferike, në shtretërit e ujrave rrjedhëse, zonat e gjelbra, në banesat ujore natyrale apo artificiale, etj. Në rast të konstatimit të kësaj dukurie operatori i shërbimit detyrohet t’i pastrojë menjëherë. Në rast të përsëritjes apo mospastrimit të tyre brenda 5 orësh nga marrja e njoftimit, përveç përgjegjësisë së mbartjes së shpenzimeve përballet me penalitete sipas kësaj kontrate dhe ligjeve e vendimeve në fuqi për ndotjen e shkaktuar.

f. Ndalohet në mënyrë kategorike ngritja e pluhurit gjatë proceseve të fshirjes për shkak të ndotjes që shkaktojnë.

g. Përdorimi i uniformave për punëtorët është rigorozisht i detyrueshëm dhe do ndërmerren gjopa për mosplotësim të tyre.

h. Gjithashtu punëtorët e pastrimit duhet të përfitojnë trajtim special në përputhje me normat higjienike në fuqi për shkak të llojit të punës që kryejnë.

26.4.5 Mjetet dhe pajisjet

Operatori i shërbimit duhet të vërë në dispozicion për plotësimin e detyrave kontraktuale të fshirjes me krahë të rrugëve dhe trotuareve si dhe të gjitha Shërbimeve Plotësuese të përcaktuara më lart, këto mjete dhe pajisje:

a. Çdo punëtorë duhet të jetë i pajisur me mjete pune pastrimi si fshesa plastike, kaci, karroca dore, lopata, etj për të mundur kryerjen me cilësi të shërbimit.

b. Pajisjet dhe veglat e punës të mbahen në gjendje të pastër dhe të mirë. Punëtorët e fshirjes duhet të jenë të pajisur: me fshesa, kruajtëse, lopata, kazane dore lëvizëse dhe karroca dore.

26.5 Fshirja e rrugëve me makineri teknologjike.

26.5.1 Volumet e Punimeve

Autoriteti kontraktor ka parashikuar paraprakisht sheshet, rrugët dhe gjatësitë lineare për të gjithë zonën e kontraktuar.

Operatori i shërbimit do të fshijë me makineri teknologjike fshesë për të gjitha rrugët dhe sheshet e përcaktuara në zonën që do të kontraktohet. në një gjatësi lineare prej **27,404** ml në ditë. Këto janë parashikuar në listën e rrugëve dhe volumet e tyre për shërbimin e fshirjes për zonën Tirana 4 (bashkëngjitur kësaj kontrate) dhe sipas hartës bashkëngjitur kësaj kontrate.

26.5.2 Specifikime teknike dhe metodologjia

Shërbimi i fshirjes së rrugëve me makineri konsiston në:

a. Fshirjen me makina teknologjike fshesë të të gjithë rrugëve kryesore, shesheve dhe rrugëve, duke mbuluar gjithë gjatësinë lineare të lirë nga parkimi. Më pas çdo mbeturinë e mbetur nga pastrimi me mjete teknologjike, pastrohet nga punëtorët e shërbimit të fshirjes me krahë..

b. Në të gjitha gjatësitë lineare dhe segmentet e lira nga parkimi, të rrugëve , të përcaktuara në volumet e shërbimit të fshirjes me makineri. Fshirja detyrimisht duhet kryer me makinë teknologjike. Në rast të kundërt do të konsiderohet i pavlefshëm shërbimi i kryer.

26.5.3 Plani i punës dhe grafikët e punimeve

a. Fshirja e rrugëve do të bëhet gjatë natës nga ora **21.00-04.00**.

b. Fshirja me makineri teknologjike do të kryhet sipas grafikëve të miratuar nga Autoriteti kontraktor, me qëllim që në orën 7.00 zona të jetë krejtësisht e pastër.

c. Grafikët e punimeve për realizimin e shërbimit të pastrimit të zones, përgatiten nga operatori i shërbimit dhe miratohen çdo vit nga Autoriteti kontraktor. Këta grafikë mund të pësojnë ndryshime në orën e operimit dhe përfundimit të shërbimit, sa herë lind e nevojshme edhe brenda një viti, vetëm për shkak të pamundësisë së kryerjes apo në rastet e ndryshimit të parkimit të makinave për rrugë të veçanta dhe ditë të veçanta dhe gjithmonë pasi të jenë miratuar zyrtarisht nga Autoriteti kontraktor këto ndryshime.

d. Në grafikun e punimeve duhet të përcaktohet saktë:

1. Oraret e operimit në secilën rrugë dhe trotuar.
2. Llojin dhe intenerarin e makinave teknologjike që do të kryejnë shërbimin.

e. Grafikët e punimeve duhet të zbatohen rigorozisht nga operatori i shërbimit. Operatori i shërbimit nuk mund të paguhet pa miratimin paraprak të grafikut të punimeve apo kur grafikut i ka kaluar afati i zbatimit.

f. Autoriteti kontraktor ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim kryerjen e shërbimeve të sipër përmendura, respektimin e standarteve të kërkuara, përdorimin e

makinave teknologjike, rregullave dhe cilësisë së kërkuar nga kjo kontratë si dhe për të vendosur penalitete, gjoba dhe ndalesa për mospërbushjen e tyre.

26.5.4 Rregulla për tu zbatuar

- a. Për asnjë rast nuk do të lejohen rrugë të papastruara apo mbeturina të pa larguara në to. Në të gjitha rastet kur evidentohen bllokime apo pengesa nga faktorë të jashtëm të cilat nuk mund të pastrohen me operacionet e parashikuara në metodologji, operatori i shërbimit duhet të njoftojë menjëherë dhe të marrë masa për pastrimin e tyre jo më vonë se 3 orë nga orari i përfundimit të shërbimit, i përcaktuar në grafik. Në rast të kundërt përgjegjësia është e operatori i shërbimit .
- b. Do të konsiderohet e pavlefshme fshirja e rrugës me makineri teknologjike për fshirjen e rrugëve, kur kjo e fundit gjatë procesit të punës operon me shpejtësi më të madhe se 6 km /orë.
- c. Operatori i shërbimit detyrimisht duhet të ketë çdo ditë (ose natë) në punë, minimalisht numrin e kërkuar të makinerive, shoferëve dhe pajisjeve për fshirjen e rrugëve.
- d. Për raste të veçanta operatori i shërbimit është i detyruar të fshijë rrugët më shumë se një herë pa shpenzime.
- e. Ndalohet në mënyrë kategorike ngritja e pluhurit gjatë proceseve të fshirjes së rrugëve, për shkak të ndotjes që shkaktojnë.

26.5.5 Mjetet dhe pajisjet

Operatori i shërbimit duhet të vërë në dispozicion për plotësimin e detyrave kontraktuale të fshirjes me makineri të rrugëve si dhe të gjitha Shërbimeve Plotësuese të përcaktuara më lart, këto mjete dhe pajisje:

- a. Makina teknologjike për fshirjen e rrugëve, me kapacitet mbajtës 4-6 m³, të pajisura me 2 fshesa anësore (majtas dhe dhjathtas) dhe një fshesë qendrore rrul, sistem thithës të pluhurave (aspirator) dhe sistem spërkatje me ujë gjatë punës, mundësisht me tub aspirimi të jashtëm thithës, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2010, jo më pak se **1 (një) copë**;
- b. Makineritë teknologjike që do përdoren për shërbimin e fshirjes duhet të jenë në përputhje me të dhënat teknike dhe specifike të mjeteve sipas ofertës dhe në përputhje me këtë kontratë si dhe të jetë konform normave teknike të Komunitetit Europian.

Rregulla të tjera për mjetet dhe pajisjet:

- a. Të gjitha automjetet të cilat duhet të përdoren nga operatori i shërbimit për fshirjen e rrugëve, mund të kontrollohen në çdo kohe nga Autoriteti kontrator për gjëndjen e gatishmërisë dhe inventarizimin e tyre.
- b. Çdo makineri për fshirjen e rrugëve duhet të lahen dhe pastrohen në fillim ose në fund të itinerarit ditor dhe duhet të jetë e pajisur me një sistem pompimi uji i cili shërben për mbrojtjen nga pluhuri.

- c. Detyrimisht në të gjithë makinat dhe kontenierët duhet të shkruhet mesazhe për edukimin ambjental, numri i telefonit i gjelbër i Autoritetit kontraktor sipas një formati të miratuar paraprakisht.
- d. Automjetet, pajisjet dhe veglat e punës të mbahen në gjendje të pastër dhe të mirë si dhe të jenë të lyera me të njëjtën ngjyrë. Një sasi e konsiderueshme e pjesëve të ndërrimit duhet të mbahen gati për të siguruar plotësimin në kohë dhe të vazhdueshëm të kësaj kontrate.
- e. Një listë e makinave fshirëse do t'i paraqitet Autoritetit kontraktor para fillimit të veprimtarisë së fshirjes.

26.6 Mirëmbajtja dhe pastrimi gjatë ditës i akseve kryesore rrugore.

26.6.1 Volumi i punimeve

Autoriteti kontraktor ka parashikuar paraprakisht të gjitha trotuaret e akseve kryesore dhe sipërfaqet e tyre për të gjithë zonën e kontraktuar.

Operatori i shërbimit do të pastrojë dhe mirëmbajë të gjitha trotuaret e akseve kryesore të përcaktuara, në zonën që do të kontraktohet, për një pjesë të rrugëve në një sipërfaqe prej **47,408 m²** në ditë nga ora 10.00 deri 18.00 .

Këto janë parashikuar në listën e rrugëve dhe volumet e tyre për shërbimin e mirëmbajtjes dhe pastrimit gjatë ditës të trotuareve për zonën Tirana 4, sipas hartës bashkëngjitur.

26.6.2 Specifikime teknike dhe metodologjia

Shërbim i mirëmbajtjes dhe pastrimit të trotuareve dhe kunetave të akseve kryesore, konsiston në:

Mirëmbajtjen dhe pastrimin me punëtorë gjatë ditës të trotuareve dhe kunetave të akseve kryesore, duke mbledhur dhe larguar të gjitha mbetjet e vogla dhe të mëdha të hedhura në sipërfaqet për mbulim si rezultat i aktivitetit tregtar dhe të këmbësorëve, mbajtjen pastër gjatë ditës të koshave rrugorë dhe vendit rreth tyre, etj

26.6.3 Plani i punës dhe grafikët e punimeve

- a. Mirëmbajtja dhe pastrimi i trotuareve do të bëhet gjatë ditës nga ora 10.00 deri 18.00
- c. Mirëmbajtja dhe pastrimi i trotuareve do të kryhet sipas grafikëve të miratuar nga Autoriteti kontraktor, me qëllim që gjatë gjithë ditës trotuarët e përcaktuar për shërbim të jenë krejtësisht e pastër ose duke u pastruar.
- c. Grafikët e punimeve për realizimin e shërbimit, pregatiten nga sipërmarrësi dhe miratohen çdo vit nga Autoriteti kontraktor. Këta grafikë mund të pësojnë ndryshime në orën e operimit dhe përfundimit të shërbimit, sa herë lind e nevojshme edhe brenda një viti, dhe gjithmonë pasi të jenë miratuar zyrtarisht nga Autoriteti kontraktor këto ndryshime.
- d. Në grafikun e punimeve duhet të përcaktohet saktë: 1. Oraret e operimit në secilën rrugë dhe trotuar. 2. Numrin e punëtorëve që do të punojnë në çdo segment rrugorë.
- e. Grafikët e punimeve duhet të zbatohen rigorozisht nga operatori i shërbimit. Operatori i shërbimit nuk mund të punojë dhe të paguhet pa miratimin paraprak të grafikut të punimeve apo kur grafikut i ka kaluar afati i zbatimit.

f. Autoriteti kontraktor ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim kryerjen e shërbimeve të sipër përmendura, respektimin e standarteve të kërkuara, rregullave dhe cilësisë së kërkuar nga kjo kontratë si dhe për të vendosur penalitete, gjoba dhe ndalesa për mospërmbushjen e tyre.

26.6.4 Rregulla për tu zbatuar

a. Për asnjë rast nuk do të lejohen trotuare të papastruara apo mbeturina të pa larguara në to. Në të gjitha rastet kur evidentohen bllokime apo pengesa nga faktorë të jashtëm të cilat nuk mund të pastrohen me operacionet e parashikuara në metodologji, operatori i shërbimit duhet të njoftojë menjëherë dhe të marrë masa për pastrimin e tyre jo më vonë se 2 orë nga orari i përfundimit të shërbimit, i përcaktuar në grafik. Në rast të kundërt përgjegjësia është e operatorit të shërbimit .

b. Operatori i shërbimit duhet të ketë në efikasitet një “Zyrë të Kontaktimit” për marrjen e ankesave e cila duhet të jetë e hapur në të gjithë ditët e javës nga ora 7.00-20.00 . Përfaqësues të operatorit i shërbimit duhet të jenë prezent gjatë gjithë kohës së parashikuar për të marrë vërejtjet e qytetarëve dhe Autoritetit kontraktor dhe për tu dhënë zgjidhje problemeve të prezantuara brenda 2 orësh nga marrja e njoftimit.

c. Operatori i shërbimit detyrimisht duhet të ketë çdo ditë në punë minimalisht numrin e punëtorëve sipas numrit të deklaruar në ofertën e tenderit për të garantuar kryerjen me cilësi dhe në kohë të këtij shërbimi.

d. Gjatë procesit të mirëmbajtjes dhe pastrimit gjatë ditës të trotuareve i ndalohet kategorikisht hedhja e mbeturinave në pusetat e elektrikut, telefonisë, të ujësjellësit, ujrave të zeza, hidrantëve, në zgarat e pusetave të ujrave atmosferike, në shtretërit e ujrave rrjedhëse, zonat e gjelbra, në banesat ujore natyrale apo artificiale, etj. Në rast të konstatimit të kësaj dukurie operatori i shërbimit detyrohet t’i pastrojë menjëherë. Në rast të përsëritjes apo mospastrimit të tyre brenda 2 orësh nga marrja e njoftimit, përveç përgjegjësisë së mbartjes së shpenzimeve përballet me penalitete sipas ligjeve e vendimeve në fuqi për ndotjen e shkaktuar.

e. Ndalohet në mënyrë kategorike ngritja e pluhurit gjatë proceseve të pastrimit gjatë ditës, për shkak të ndotjes që shkaktojnë.

f. Përdorimi i uniformave për punëtorët është rigorozisht i detyrueshëm dhe do ndërmerren gjoba për mosplotësim të tyre.

h. Gjithashtu punëtorët e pastrimit duhet të përfitojnë trajtim special në përputhje me normat higjienike në fuqi për shkak të llojit të punës që kryejnë.

28.6.5 Mjetet dhe pajisjet

1. Çdo punëtorë duhet të jetë i pajisur me mjete pune pastrimi si fshesa plastike, kaci, karroca dore, lopata, etj për të mundësuar kryerjen me cilësi të shërbimit.

26.8 Larja e rrugëve me makinë teknologjike

26.8.1 Volumet e Punimeve

Autoriteti kontraktor ka parashikuar paraprakisht sheshet, rrugët dhe sipërfaqet e tyre që do të lahen me presion për të gjithë zonën e kontraktuar si për shërbimin e parë të larjes gjatë natës ashtu dhe për shërbimin e dytë të larjes gjatë ditës.

1. Operatori i shërbimit do të bëjë larjen me presion të rrugëve me makinë teknologjike, si shërbim një herë në ditë gjatë natës, parashikuar në metodologji për të gjitha rrugët dhe sheshet e përcaktuara, në zonën që do të kontraktohet, në një sipërfaqe të përgjithshme prej **136,735** m² në ditë përgjatë 305 ditëve të periudhës kontraktuale. Këto janë parashikuar në listën e rrugëve dhe volumet e tyre për shërbimin e larjes me makineri për zonën Tirana 4.

2. Operatori i shërbimit do të bëjë larjen me presion të rrugëve me makineri si shërbim i dytë ditor, si larje gjatë ditës në një sipërfaqe të përgjithshme prej **61,360** m²/ditë, sipas listës së rrugëve dhe volumeve të përcaktuara për larjen dy herë në ditë, për zonën Tirana 4 përgjatë muajve më të nxehtë të vitit.(gjithsej 240 ditë)

26.8.3 Specifikimet teknike dhe metodologjia

Shërbimi i larjes me presion, me makineri teknologjike konsiston në:

1. Larjen me presion me makineri teknologjike larëse, si shërbim një herë në ditë, të gjithë rrugëve kryesore, shesheve dhe rrugëve dytësore të parashikuara, në mënyrë që makinat larëse të mbulojnë me shërbim të gjitha sipërfaqet e plota të tyre brenda kohës së parashikuar.

2. Larjen me presion, me makineri teknologjike larëse, si shërbim i dytë ditor, të të gjithë rrugëve kryesore, shesheve dhe rrugëve dytësore të parashikuara për këtë shërbim, në mënyrë që makinat larëse të mbulojnë me shërbim të gjitha sipërfaqet e plota të tyre brenda kohës së parashikuar.

3. Gjatë shërbimit të parë të larjes (gjatë natës) shpejtësia e operimit të makinave larëse gjatë procesit të larjes (zbrazjes së ujit) duhet të variojë nga 8-10 km/orë kurse gjatë shërbimit të dytë të larjes nga 15-20 km/orë.

26.8.4 Plani i Punës dhe grafikët e punimeve

1. Larja e rrugëve, si shërbim një herë në ditë, do të bëhet çdo ditë, gjithmonë mbas shërbimit të pastrimit (fshirjes) të rrugëve, nga ora 24.00-07.00.

2. Larja e rrugëve si shërbim i dytë ditor, do bëhet çdo ditë, gjatë periudhës 15 Mars – 15 Nëntor , (gjithsej 240 ditë) nga ora 12.00 –19.00.

3. Larja me presion, me makinë teknologjike do të kryhet me grafikë të miratuar nga Autoriteti kontraktor, me qëllim që në orën 07.00 dhe në orën 19.00 për shërbimin e dytë të larjes, zona e kontraktuar të jetë krejtësisht e larë.

4. Grafikët e punimeve për realizimin e shërbimeve të larjes së rrugëve, përgatiten nga Operatori i Shërbimit dhe miratohen çdo vit nga Autoriteti kontraktor. Këta grafikë mund të

pësojnë ndryshime në orën e operimit dhe përfundimit të shërbimit, sa herë lind e nevojshme edhe brenda një viti, vetëm për shkak të pamundësisë së kryerjes dhe gjithmonë pasi të jenë miratuar zyrtarisht nga Autoriteti kontraktor këto ndryshime.

5. Në grafikun e punimeve duhet të përcaktohen saktë: 1. Oraret e operimit në secilën rrugë dhe trotuar. 2. Llojin dhe intinerarin e makinave teknologjike që do të kryejnë shërbimin. 3. Numrin e punëtorëve që do të punojnë në çdo operacion punimesh.

6. Grafikët e punimeve duhet të zbatohen rigorozisht nga operatori i shërbimit. Operatori i shërbimit nuk mund të punojë dhe të paguhet pa miratimin paraprak të grafikut të punimeve apo kur grafikut i ka kaluar afati i zbatimit.

7. Autoriteti kontraktor ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim kryerjen e shërbimeve të sipër përmendura, respektimin e standarteve të kërkuara, rregullave dhe cilësisë së kërkuar nga kjo kontratë dhe për të vendosur penalitete, gjopa dhe ndalesa për mospërbushjen e tyre.

26.8.5 Rregulla për tu zbatuar

1. Autoriteti kontraktor ka të drejtë të kontrollojë gjatë kryerjes së shërbimit dhe pas përfundimit të tij, respektimin e standarteve në presionin e ujit për larje si dhe duke kontrolluar herë pas here sasinë e ujit të përdorur për larjen e sipërfaqes së parashikuar. Në rastet kur evidentohet presion i pamjaftueshëm në larje apo sasi e vogël e ujit të përdorur, shërbimi i larjes do të konsiderohet i pavlefshëm.

2. Operatori i Shërbimit duhet të kryejë shërbimin e larjes me presion të rrugëve duke respektuar standartin e harxhimit të 0,8 litër ujë për 1 m² rrugë për larjen e darkës dhe 0.6 litër ujë për m² për larjen e ditës.

3. Larja duhet të bëhet me ujë me ngarkesë bakteriale jo më shumë se 200 E koli për 100ml ujë.

4. Në të gjitha rastet kur nuk është e nevojshme kryerja e shërbimit të larjes me makineri për shkak të kushteve atmosferike si shi apo ngricë, Operatori i shërbimit nuk do të kryejë këtë shërbim dhe si rrjedhim nuk do të paguhet.

5. Përfaqësuesit e Autoritetit kontraktor do të shënojnë në procesverbalet ditore dhe situacionet mujore, të gjitha ditët dhe volumet përkatëse, që për shkak të reshjeve nuk është kryer shërbimi i larjes së dytë dhe mund ti kërkojë Operatorit të Shërbimit kryerjen e këtij shërbimi në ditët e tjera të vitit ose gjatë stinës së verës kur të jetë e nevojshme, në përputhje me çmimet njësi të preventivit të punimeve dhe sipërfaqeve të rrugëve sipas listës së rrugëve bashkëngjitur kontratës, një kërkesë zyrtare të Autoritetit kontraktor, si dhe pagesa do të bëhet atëherë kur të kryhet.

6. Do të konsiderohet e pavlefshme larja e rrugëve në kushtet e reshjeve atmosferike të përshkruara më sipër. Do të bëjë përjashtim vetëm në rastet kur kryerja e këtij shërbimi kërkohet nga Autoriteti kontraktor për shkaqe të ndryshme.

7. Autoriteti kontraktor do të nxisë Operatori i shërbimit në të përdorë burime të tjera për sigurimin e ujit për larjen e rrugëve, si puse, etj.

8. Listat përkatëse të rrugëve që do lahen i bashkëngjiten kësaj kontrate.
9. Të gjitha shpenzimet për ujin, që do të përdoret për larje, do mbarten nga operatori i shërbimit.
10. Operatori i shërbimit detyrimisht duhet të ketë çdo ditë (ose natë) në punë, minimalisht numrin e kërkuar të makinerive dhe pajisjeve për larjen e rrugëve.

26.8.6 Mjetet dhe pajisjet për larjen e rrugëve

Operatori i shërbimit duhet të sigurojë për realizimin e larjes me presion të rrugëve sipas përcaktimeve të kontratës, të gjitha punimet, materialet, pajisjet si dhe lejet përkatëse.

Operatori i shërbimit duhet të vërë në dispozicion dhe të përdorë për plotësimin e detyrave kontraktuale të larjes së rrugëve këto mjete:

1. Makina për larjen e rrugëve, (autobote) të pajisura me pompë për larjen e rrugëve me presion, me dy ose më shumë pjata larëse në pjesën e përparme, me kapacitet mbajtes jo më pak se 10000 litra ujë, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2010 jo më pak se **2 (dy) copë**; Të jetë konform normave teknike të Komunitetit Europian.
2. Të gjitha automjetet të cilat do të përdoren nga operatori i shërbimit për plotësimin e detyrimeve kontraktuale, mund të kontrollohen në çdo kohë nga Autoriteti kontraktor për gjëndjen e gadishmërisë dhe inventarizimin e tyre.
3. Të gjitha makinat për larjen e rrugëve duhet të mbahen në gjendje të pastër dhe të mirë, si dhe të jenë të lyera me të njëjtën ngjyrë.
4. Një sasi e konsiderueshme e pjesëve të ndërrimit duhet të mbahen gati për të siguruar plotësimin në kohë dhe të vazhdueshëm të kontratës.
5. Detyrimisht në të gjithë makinat duhet të shkruhet mesazhe për edukimin ambjental, numri i telefonit i gjelbër i Autoritetit kontraktor sipas një formati të miratuar paraprakisht.
6. Një listë e makinave larëse do t'i paraqitet Autoritetit kontraktor para fillimit të veprimtarisë së larjes.

26.9 “Edukimi Publik Mjedisor”

Në termin “Edukim Publik”, do të nënkuptohet aktiviteti publicitar i operatori i shërbimit për të rritur dhe përmirësuar njohuritë e konsumatorit përsa i përket mbledhjes, përpunimit dhe largimit të mbetjeve, ndarjes së mbetjeve në burim, etj periudhës së kontratës.

Operatori i shërbimit duhet të krijojë një kontakt të vazhdueshëm me komunitetin e zonës i cili luan një rol të rëndësishëm jo vetëm në mbarëvajtjen e punës së operatori i shërbimit por edhe në minimizimin e ndotjes së ambjentit.

Operatori i shërbimit duhet të mundësoj shpërndarjen e materialeve informative të paktën nje here ne gjashte muaj (duke filluar nga dita e firmosjes se kontrates). Materialet informative duhet të jenë në formën, fletëpalosjeve si dhe broshurave duke përfshirë në to informacione mbi shkaqet dhe shkaktarët e kësaj ndotjes, parandalimin e saj si dhe masat që mund të merren për minimizimin e ndotjes. Materialet sensibilizuese duhet të jenë të tilla që të ftojnë qytetarët e kryeqytetit të bëhen pjesë aktive e një shoqërie të emancipuar dhe me një edukatë mjedisore.

Programi i edukimit mjedisor që do të bëjë operatori i shërbimit duhet të miratohet nga Autoriteti kontraktor.

Në rast të mos përmbushjes të edukimit mjedisor apo plotësimit të pjesshëm të tij aplikohen penalitete.

26.10 Specifikimet teknike të Kontenierëve

Sasia e kërkuar e kontenierëve për zonën “Tirana IV” është 1532 copë.



LARTËSIA (A)	MM	1420
GJATËSIA (B)	MM	1770
GJËRËSIA (C)	MM	1170
DISTANCA NGA TRUPI I KONTENIERIT – TOKË (G)	MM	200
TRASHËSIA E LLAMARINËS	MM	1.5 - 4



Materiali qellim

**TE DHENA
1700 LITRA:**

fotografik shërben për informues dhe orientues.

TEKNIKE TE KONTENIERIT

Kontenierët do të përdoren për grumbullimin e mbetjeve urbane dhe duhet të kenë karakteristikat si më poshtë vijojnë:

Trupi i kontenierit (vaska):

Trupi i kontenierit nga brenda (vaska e zinguar). Ekstra përforcim i bazës së rrotës, i ngjitur tek kontenieri. Sistem kullimi fundor për derdhjen e lëngjeve të grumbulluar nga mbetjet apo gjatë larjes së kontenierit. Kapaciteti i plote 1700 litra. Doreza anesore për terheqjen e kontenierit.

Kontenierët duhet të jenë të lyer me bojë(vaska) Portokalli,(kapaku i kuq). Spesori i profilit të vaskës 1.5-4 mm.

Kapaku

Metalik. Me përforcues të tërthortë për ekstra rezistencë.Profil i harkuar ose i drejtë për rrjedhje të ujrave të shiut. Sistemi i hapjes së kapakut me pedale qendrore. Ndër të tjera kapaku duhet jetë i pajisur edhe me një dorezë, në pjesën e përparme ose anesore, për raste të hapjes së kapakut në mënyrë manuale.Ngjyra e kapakut, e kuqe.

Pedalja

Pedalja duhet të jetë me profil metalik me spesor 4 mm për ekstra rezistencë.

Rrotat

Rrota rezistente me çelik të galvanizuar në qendër dhe unazë gome rezistente në pjesën e kontaktit me tokën. Diametri i rrotës 200mm dhe me rrotullim 360°. 4 rrota të kthyeshme (me kokë rrotulluese), me gomë plastike solide, me kuzhineta, kapaciteti mbajtës për rrotë të jetë 250kg;

Modeli i kapjes së kazanit

Attacco Bologna/ Din.

Sinjalistika

Operatori duhet të sigurojë dhe ngjisë adezivë tek kazanët, me informacion mbi mënyrën e dorëzimit të mbetjeve, ndalimet, eiket, adëzivë për ndalim parkimi para kazanëve, shirita me ngjyre fosforeshente, logo e Bashkisë së Tiranës. (Pas miratimit të formatit nga Bashkia Tirane). Ofertuesi mund të ofrojë edhe modele të tjera por duke marrë paraprakisht miratimin e autoritetit kontraktor si dhe duke respektuar gjithnjë kohën e parashikuar për dorëzimin e kontenierëve.

Targë e fiksuar (gozhduar) ose e stampuar

Mbi çdo kazanë, nga prodhuesi, do të fiksohet një targë me dimension 10cm x 4cm ku do të stampohet një kod identifikimi për kazanin me 6 shifra (duke u nisur nga 000000 e deri në 002500), viti i fabrikimit të kazanit dhe kapaciteti.

Përputhja

Sipas normativës UNI EN 840 (UNI 10571).

Të tjera.

Kazani duhet të jetë në gjendje të durojë gjatë kohës, për të gjithë përbërsit, temperatura nga -20°C deri +50°C;

Kazani duhet të strukturuar në mënyrë që të garantojë një mbajtje peshe deri në 450kg, pa pësuar asnjë deformim permanent

Hapja minimale, me gjysëm pedale duhet të jetë 450mm, ndërsa në fazën e zbrazjes ose të larjes duhet të jetë minimalisht 1000mm.